



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.585/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Shkëlqim Hebibi, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar Anr.585/2021 i paraqitur nga Shkëlqim Hebibi, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Shkëlqim Hebibi në të cilin pretendon se nuk është në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe nuk ka asnjë njoftim nga KQZ për këtë.

Me datë 01.09.2021 PZAP, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 16:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se apeluesi Shkëlqim Hebibi është në listën e votuesve jashtë Kosovës me numër të regjistrimit të KQZ-së 2021171008831 ndërsa arsyeja se përse ankuesi nuk e ka gjetur emrin në listën e votuesve jashtë Kosovës është se në këtë listë mbiemri është Habibi dhe kjo do të përmirësohet dhe ankuesit do t'i korrigjohen të dhënat e sakta sikurse i ka dhënë në aplikacionin për regjistrim.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Shkëlqim Hebibi, në të cilin pretendon se nuk është në listën e votuesve jashtë Kosovës Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021 dhe nuk ka asnjë njoftim nga KQZ për këtë.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ-ja me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit se Shkëlqim Hebibi është në listën e votuesve jashtë Kosovës me numër të regjistrimit të KQZ-së 2021171008831 ndërsa arsyeja se përse ankuesi nuk e ka gjetur emrin në listën e votuesve jashtë Kosovës është se në këtë listë mbiemri është Habibi dhe kjo do të përmirësohet dhe ankuesit do t'i korrigjohen të dhënat e sakta sikurse i ka dhënë në aplikacionin për regjistrim.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti do të përfshihet në listën e votuesve me përmirësime.

Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Shkëlqim Hebibi gjendet në listën votuese.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërhënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.585/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushëvci



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.